



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12 prot

Tepelenë, më 25. 11. 2024

PROCES-VERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 25.11.2025, ora 11:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 31.10.2025.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Tetor 2025.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Tetor 2025.”
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e planit të punës, planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit të këshillit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026.”
6. Prezantim i Raportit të performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2024
7. Çështje të tjera
8. Kërkesa ankesa të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Arben Gumeni, drejton mbledhjen. Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00.

Këshilltarët pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Miftar Meta, Mjaftoni Zera, Mirela Varfi, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ditar Hodaj, Matilda Cela

Prezent nga Administrata e Bashkisë:



- Armand Sala
- Festime Elezi
- Rovenà Mullaraj
- Ela Skenderaj
- Xhulia Meta

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni, deklaron hapjen e mbledhjes dhe paraqet rendin e ditës, Jeni dakort me rendin e dites?

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Votimi: Vota Pro (12): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mirela Varfi, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela.

Vota Kundër: S'ka.

Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 31.10.2025.

Kryetari i Këshillit drejton pyetje lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi: **Votimi:** Vota Pro (12): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mirela Varfi, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela.

Vota Kundër: S'ka.

Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Tetor 2025.

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Cela Kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Kjo pike e rendit të ditës nuk ka ndryshim nga muaji I kaluar trajtohen me f ndihmës ekonomike me fond 6%, 11 familje me fond 46,036 lekë.

- Njësia Qytet: 7 familje
- Njësia Kurvelesh: 1 familje
- Njësia Lopës: 1 familje
- Njësia Qëndër: 2 familje

Kryetari i Këshillit ka pyetje /JO

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit.

Votimi: **Votimi:** Vota Pro (12): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mirela Varfi, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

Projektvendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Tetor 2025.
Fjalën e mori Znj. Matilda Cela Kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Për muajin Tetor trajtohen me ndihmë ekonomike fondi I bashkisë 91 familje me fond 231.178 leke

Njësia Qëndër: 52 familje

Njësia Qytet: 35 familje

Njësia Kurvelesh: 2 familje

Njësia Lopës: 2 familje

1 shtese ka muaji Shtator. Propozohet te hidhet ne votim.
Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit.

Votimi: Votimi: Vota Pro (12): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mirela Varfi, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

10. Projektvendim: “Për miratimin e planit të punës, planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit të Këshillit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026”

Matilda: Anëtarët e Këshillit janë njohur me materialin e dërguar në adresat e tyre të email-it, të cilin e kanë edhe të printuar. Ne jemi mbledhur dhe kemi diskutuar me komisionin, Kryetarin dhe Sekretaren e Këshillit Bashkiak për përshkrimet e planit të aktivitetit, të bashkëlidhura sipas materialit. Ndryshim nga plani i vitit të kaluar kemi nismën e Këshillit Bashkiak:

Nismë e Këshillit Bashkiak me projektvendim për markimin e shtigjeve që kalojnë në zonat ku ka stane, për të promovuar dhe standardizuar turizmin malor sipas manualit kombëtar, sidomos traditën e staneve dhe shtigjeve si pjesë e turizmit rajonal. Synojmë të zhvillojmë ekonominë familjare të barinjve dhe të fusim Bashkinë e Tepelenës në hartën rajonale të shtigjeve për të targetuar turistët me këtë interes.

Nismë për financimin e transportit për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë “A. Shehu” Tepelenë, të cilët vijnë nga familje me vështirësi financiare (në fokus familjet me prindër të divorcuar dhe me një prind).

Në komision diskutuam që pika 10 Fushatë informuese – Open Day nga 70.000 lekë të bëhet 50.000 lekë. Pikë tjetër që duhet shtuar është ajo e propozuar nga këshilltari Latif Kaçaj, për financimin e transportit për këshilltarët që vijnë nga zonat rurale.

Ditar: Këshilltari ka pagesën, mos të kandidojë nëse nuk i leverdis.

Matilda: Aktiviteti Tetori Rozë është i përvitshëm. Dërgimi me postë i materialeve, që është vetëm për një këshilltar, është 5.000 lekë të reja.

Për pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete të ngjashme, te pika 15, aktualisht anëtarët e Këshillit, kur nuk u paguhet transporti, nuk marrin pjesë në trajnime. Këtu duhet të kemi fokus. Janë 20.000 lekë për dy këshilltarë në vit. Shuma që u hoq nga pika 10 të shtohet te pika 15.

Blerje pajisjesh për transmetimin live të mbledhjeve nuk e ndryshojmë, sepse do mundohemi ta realizojmë këtë vit.

Blerje kondicioneri për sallën e Këshillit mbetet, ndërsa printerin e heqim pasi është blerë i ri dhe këtë shumë do ta shtojmë te zëri për trajnime.

Buxheti mbetet në vlerën 2 milionë lekë. Ndryshojmë vetëm zërat. Gjatë vitit mund të bëjmë edhe rishikime për zërat që nuk realizohen plotësisht.
Jeni dakord? Keni ide?

Arben: Vlerat dhe zërat nuk ndryshojnë.

Ditar: Për pagesat e transportit jam kundër. Do propozoja që në tavolinë secili të ketë paisjen e vet.

Arben: Është planifikuar te zëri Pajisje transmetimi.

Latif: Te ndryshimi i zërave për transportin e këshilltarëve, në trajnimet që kemi bërë na është thënë që këshilltari i zonës rurale mund të marrë dietë. Unë vij 3 ose 4 herë për interes të komunitetit, në komision dhe në mbledhje.

Ditar: Transporti nuk është i parashikuar në pagesë, nuk e ka ligji.

Arben: Ta hedhim në votim planin. Ka pyetje?

Ditar: Unë jam që materialet t'i marrin dorazi këshilltarët.

Arben: Anëtarët e Këshillit që kanë nevojë për të printuar materialet mund të vijnë t'i printojnë. Ta hedhim në votim. Ka pyetje? Jo.

Votimi: Vota Pro (12): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Marsela Balili, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Mirela Varfi, Miftar Meta, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Besnik Maça, Esmeralda Bishani, Matilda Çela. Vota Kundër: S'ka. Vota Abstenim: S'ka.

Arben: Kemi raportim nga administratori i Njesisë Administrative Lopës. (Bashkëlidhur materiali)

Matilda: Për ujin nuk mund të themi që jemi në kushte krize sepse ka një ndërmarrje ujësjellësi. Nëse ju nuk kërkon llogari, na thoni neve.
Rruga, sapo mbaron asfalti, është më keq se uji; aty nuk kalojnë dot as makinat dhe as furgonët që sjellin nxënësit. Nuk e di si kalojnë. Rrugët janë bërë të pakalueshme.

Ashtu si thatë, duhet të bëhet me beton. Aty kalojnë vetëm makinat e mëdha. Një makinë e mirë nuk futet në rrugët e fshatit Sinanaj, as në Mato-Hasanaj. Situatë emergjente. Çfarë do bëhet?

Deri tani keni bërë vetëm çezma në Dhembelë. Kaloni njëherë në fshatrat e tjerë: Dorëz, Sinanaj. Rruga te varrezat është rrethuar, por një shi të bjerë, nuk shkon dot.

Emergjencë është rruga ku kalon furgoni me nxënës. Rruga Mato-Hasanaj – Sinanaj është emergjente.

Për pastrimin e rrugës Sinanaj–Tepelenë bien gurë; të vihen punëtorët në punë.

Administratorin e qytetit e kemi kërkuar disa herë të na vijë për të dhënë informacion.

Qyteti është në gjendje katastrofe. Plani Kombëtar i Pastrimit të Territorit në Tepelenë nuk kemi parë asgjë.

Vladimir Bakiaj: Për ujësjellësin, para dy vitesh ishte koha që do merrej ujësjellësi në dorëzim. Keni dhënë firmë?

Latif: Administratori nuk foli për taksat dhe tatimet. Sa janë mbledhur gjatë vitit?

A i kanë paguar taksat barinjtë që kanë marrë malin me kullotë?

Pse kanë ikur vlonjatët pa paguar malin? Ku kanë vajtur lekët e tyre?

Mjaftoni: Problemet që ngriti Arturi qëndrojnë. Ai është në dispozicion të komunitetit për situatat emergjente. Tani erdhi skrepi dhe ndërhyri në rrugën Mato-Hasanaj – Sinanaj. Ajo rrugë ka nevojë për asfalt. Çfarë t'i kërkojmë Arturit, t'ia parashtrojmë financës dhe bashkisë kur të vijë projektbuxheti 2026.

Të dimë sa do investohet në zonën tonë. A do të asfaltohet rruga Sinanaj – Mato-Hasanaj?

Arturi të mbajë përgjegjësi për atë që i takon, sepse investimet i bën bashkia. Nëse bashkia nuk sjell investime për rrugët, çfarë duhet të bëjë ai?

Ujë nuk ka, drita nuk ka – këto t'i kërkojmë te projektbuxheti 2026.

Arben: Cila është pyetja jote? Arturi foli për punët e bëra në njësi; investimet i ka bashkia. Bëni pyetje për punët që ka bërë Arturi në njësi dhe çfarë do bëhet.

Latif: Para 15 ditësh në Njësinë Lopës kanë qëndruar mjetet e bashkisë, fadroma. Çfarë ka bërë? Varrezat janë pa pastruar.

Arben: Mjetet i komandon bashkia.

Latif: I komandon njësia

Artur: Ju falënderoj për pyetjet.

Investimi te çezmat është bërë në Sinanaj, Qendër dhe Dashaj.

Për ujësjellësin nuk është firmosur, nuk është vendosur në të gjithë njësinë; është bërë vetëm në fshatin Dhembelë dhe është funksional; banorët kanë bërë kontrata me ujësjellësin.

Në fshatin Sinanaj nuk ka investim për furnizimin me ujë të pijshëm.

Për mjetet: i ka bashkia në dorë. Të gjitha shqetësimet i kam të protokolluara në bashki.

Për taksat e kullotave: Ministria kishte nxjerrë urdhër për ndërprerjen e kullotave, jo vetëm në njësinë tonë. Punonjësi i taksave ka dalë në pension dhe detyrat i ka marrë punonjësi i bashkisë. Janë përgatitur kontratat dhe të gjitha lekët do mblidhen është bërë njoftimi. Ky shqetësim është i drejtë sepse është e ardhur për njësinë.

Arben: Artur, të falenderoj për materialin.

Pika 6. Prezantimi i Raportit të Performancës së Bashkisë Tepelenë për Vitin 2024

Ela Skënderaj: Prezantohet si pjesë e njësisë së performancës. Granti i performancës ka të bëjë me matjen e sistemit të performancës. Ky sistem ndodh pas një pune 4-mujore, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe projektit “Bashki të Forta”.

Po ja kaloj fjalën koordinatorës së performancës për të relatuar relacionin:

Ky relacion paraqet përmbledhjen e performancës së Bashkisë Tepelenë për një sërë shërbimesh publike, të cilat lidhen drejtpërdrejt me funksionet e vetëqeverisjes vendore dhe me detyrimet ligjore të transferuara nga qeverisja qendrore. Dokumenti synon të informojë Këshillin Bashkiak mbi ecurinë, rezultatet, sfidat dhe rekomandimet për vendimmarrjet e mëtejshme

II. Arsimi Parashkollor dhe Bazë

Gjatë periudhës së raportimit, Bashkia Tepelenë ka garantuar:

- Mirëmbajtje 100% të ndërtesave të kopshteve dhe shkollave.
- Stabilitet në numrin e fëmijëve dhe mësuesve në sistemin parashkollor (192 fëmijë – 33 mësues).
- Kapacitete të plota në arsimin 9-vjeçar, me rreth 1000 nxënës çdo vit.
- Raport mësimdhënieje brenda standardeve kombëtare

III. Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

- Ndërtesat e gjimnazit janë 100% funksionale.
- Rreth 236 nxënës të regjistruar në tre vitet e fundit.
- Konvikti i shkollës akomodon mesatarisht 8 nxënës në vit.

IV. Shërbimi i Ujitjes dhe Kullimit

- Pastrimi i kanaleve vaditëse: 35.8% e rrjetit.
- Pastrimi i kanaleve kulluese: 73% e rrjetit në vitin 2026.
- Sipërfaqja e tokave bujqësore të mbuluara nga sistemi i ujitjes: 60.6%.
- Familjet përfituese: 220.

V. Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

- Administrimi i 29,000 ha pyje dhe kullota.
- Rritje e inspektimeve dhe kontrolleve në terren.
- Rritje e fondeve për menaxhimin pyjor deri në 13 milion lekë.
- Stabilitet i të ardhurave nga qiratë dhe tarifat.

VI. Shërbimi Zjarrfikës dhe Mbrojtja Civile

- Struktura funksionale sipas organikës.
- Nevojë për mjete të reja zjarrfikëse.
- Nevojë për pajisje mbrojtëse dhe trajnime shtesë.

VII. Përfundime

- Mirëmbajtje 100% e infrastrukturës arsimore.
- Përmirësime të ndjeshme në rrjetin e ujitjes dhe kullimit.
- Rritje e inspektimeve në pyje dhe kullota.
- Stabilitet në të ardhurat nga asetet natyrore.

Sfida të Identifikuara

- 1.Modernizimi i flotës së mjeteve zjarrfikëse dhe pajisjes së stafit me mjete bashkëkohore të sigurisë.
- 2.Investime të domosdoshme në rehabilitimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të amortizuara.
- 3.Zhvillimi i turizmit si instrument për rritjen e ekonomisë vendore dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve turistike.
- 4.Investime në infrastrukturën e pyjeve dhe kullotave, përfshirë rikonstruksionin e rrugëve pyjore, ndërtimin e lerave, si dhe pajisjen e strukturave me automjete të përshtatshme për terrene të vështira.

Rekomandime

- 1.Miratimi i fondeve shtesë për sistemin e ujitjes dhe kullimit, me fokus në zonat me amortizim të lartë.

2.Miratimi i fondëve për investime në infrastrukturën e pyjeve dhe kullotave, përfshirë rrugët pyjore, lerat dhe pajisjen me automjete për terrene të vështira.

3.Pajisja e shërbimit zjarrfikës me automjete të reja dhe mjete bashkëkohore të ndërhyrjes.

4.Rritja e stafit inspektues në sektorin e pyjeve dhe në shërbimin e ujitjes, si dhe trajnimi i vazhdueshëm profesional.

5.Mbështetja e investimeve në infrastrukturën arsimore, veçanërisht në mjedise, laboratorë dhe konvikte.

6.Mbështetje për projektet në fushën e turizmit, me synim rritjen e ekonomisë vendore dhe cilësisë së shërbimeve turistike.

Ky relacion i paraqitet Këshillit Bashkiak për informim, analizë dhe vendimmarrje, në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së jetës për qytetarët e Bashkisë Tepelenë.

Ditar: Ky relacion, për cilin vit është?

Xhulia: Për vitin 2024.

Ditar: Na thoni çfarë keni bërë, jo çfarë doni të bëni.

Ela: 2024 është viti i matjes së performancës, e cila publikohet në 2024 sipas pyetjeve që na vijnë nga AMMV.

Dutar: Pastrimi i kanaleve kulluese 70% deri në 2026?

Ela Skënderaj: Po, janë të përcaktuara planet dhe faktet.

Ditar: Faqja 2, pika 4 – te pika 2 Arsimi parashkollor dhe bazë thotë *brenda standardeve kombëtare*. Si e kuptoni ju këtë?

Ela Skënderaj: Ne bazohemi tek stabiliteti i numrit të fëmijëve dhe mësueseve në sistemin parashkollor.

Ditari: Mësimdhënia, si plotësohet? Që të jetë brenda standardeve kombëtare duhet të ketë laboratorë, të ketë tualete funksionale 100%, gjë që nuk i keni.

Ela: Pyetësi vjen i gatshëm nga Agjencia e Vetëqeverisjes Vendore dhe në bazë të tij dalin raportet për të cilat çdo drejtori është përgjegjës.

Ditar: Shkollat i kam parë kanë laboratorë?

Ela Skënderaj: E kemi vendosur si sfidë për t'u përmirësuar.

Ditar: Atëherë pse thoni që shkollat janë brenda standardeve kombëtare?

Arben: Ka pyetje të tjera?

Matilda, Tek performanca e kopshteve dhe shkollave nuk ka 100%. Shkolla “7 Marsi” dhe “Abas Shehu” kanë lagështi dhe probleme në rrethim. Kopshte duhet të inspektohen nga Këshilli, sepse prindërve u kërkohen gjëra minimale (letër higjienike, sapun), të cilat duhet t’i sigurojë institucioni. Raporti i mësimdhënies jepet nga Ministria e Arsimit përmes inspektimeve.

Shërbimi Zjarrfikës vlerësimet pozitive. Aksioni Kombëtar i Pastrimit, në Tepelenë nuk është bërë asgjë. Raporti duhet të jetë si ka qenë dhe si është bërë,

Ditar: Tek pika 4 ujitja dhe kullimi duhet të dihen vendet ku janë pastruar kanalet. Të specifikohet ku planifikohet sistemi i ujitjes dhe cilat zona bujqësore përfshihen. Për pyjet e kullotat duhet të jepen detaje për zonat ku është bërë pastrimi dhe mirëmbajtja.

Ela Skënderaj: Për ujitjen dhe kullimin është një specialist që ka plotësuar pyetësin. Të gjitha të dhënat janë në raportin e performancës sipas kërkesave të AMMV.

Ditar: A ka rampe në institucionet e arsimit parashkollor dhe të mesëm?

- A kanë tualete të ndara për meshkuj e femra në kopshtet?
- Faqja 7 mbi zhvillimin e industrisë së lehtë dhe ushqimore pse përmenden investime që nuk janë të Bashkisë p.sh., Uji i Ftohtë, investimi i peshkut në afërsi të Hormovës?
- Çfarë është bërë nga Bashkia Tepelenë për të frenuar largimin e qytetarëve?
- Çfarë është bërë për mbylljen e burgut të Tepelenës? Pse nuk ka qëndrime?
- Si shpjegohet që popullsia bie, por numri i nxënësve rritet? A ka abuzim me regjistrimet?
- Gjendja e infrastrukturës në Kopshte dhe shkolla është e dobët Shkolla e Nivicës rrezik infeksionesh

Si shpjegohet rritja e shpenzimeve? Tek faqja 20 Nuk kuptohet ndryshimi mes rreshtit të dytë dhe të tretë në treguesit e performancës.

Arben: Për këto pyetje kërkoj që drejtorët të jenë të pranishëm në mbledhjen e radhës për të raportuar mbi performancën.

Ditar: Mos të tallen me këshilltarët. Kam probleme me mbetjet – ku shkojnë? Materiali ka ardhur dhe kam të drejtë ta diskutoj.

Arben: Drejtorët të paraqiten në mbledhjen e ardhshme për raportimin e performancës.

KËRKESA DHE ANKESAT E QYTETARËVE

1. Kërkesa nga familjarët e Dëshmorit të Atdheut, Dule Dalani, për vendosjen e bustit.

Arben: Sipas rregullores, bustet vendosen vetëm për persona me titull “Hero i Popullit”, “Nderi i Kombit”. Nëse ne vendosim për një rast, do të krijohet precedent për të gjithë. Kërkesat duhet të vijnë nga shoqatat. Nuk kalon në Këshill.

2. Kërkesë nga znj. Mysibe Malo për ndihmë në riparimin e banesës.
Kjo kerkese ti delegohet te Bashkia, te zyra përkatëse.

3. Kërkesë nga z. Engjëll Dalani për ndihmë në riparimin e banesës.
Kjo kerkese ti delegohet te Bashkia, te zyra përkatëse.

4. Kërkesë nga znj. Ruzhdiqe Halili, pensionist, për ndihmë financiare për riparimin e çatisë.
Kjo kerkese ti delegohet te Bashkia, te zyra përkatëse.

5. Kërkesë nga z. Neshet Haderi për dëme natyrore në rrugën hyrëse të banesës.
Kjo kerkese ti delegohet te Bashkia, te zyra përkatëse.

6. Kërkesë nga Shoqata e Pronareve të Kullotave Private, Kurvelesh, për rishikimin e taksës kullosore.
Kjo kerkese ti delegohet te Bashkia, te zyra përkatëse.

7. Kërkesë nga z. Astrit Halili për ndihmë financiare për arsye shëndetësore.
Delegohet te zyra përkatëse.

8. Kërkesë nga Shoqëria Vodafone për marrje në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor-kullosor.
Ti delegohet Bashkise zyra përkatëse, në të mirë të komunitetit.

Mbyllet mbledhja e këshillit në orën 12:42.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI

